



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, Gazeta Zyrtare e Republikës, Nr. 22 e datës 12.10.2023, Rregullores (QRK)-Nr.01/2025 për Mekanizmin koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje , dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E MEKANIZMIT KOORDINUES LOKAL PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE NË KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1

1. THEMELOHET, Mekanizmi Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore në Komunën e Lipjanit, (në vazhdim të tekstit Mekanizmi koordinues lokal) në përbërje si vijon:

- 1.1. Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës – Kryesues;
- 1.2. Shkëlzen Hajdini, Drejtori i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar;
- 1.3. Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale, anëtare;
- 1.4. Hyrije Qerkini , Zyrtare në Qendrën për Punë Sociale, anëtare;
- 1.5. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsimt, anëtar;
- 1.6. _____ , Zyrtar/epër Barazi Gjimore, anëtar/e;
- 1.7. Agim Krasniqi Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, anëtar;
- 1.8. Lidija Jovanovic, Përfaqësuese nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, anëtare;
- 1.9. Zana Asllani, Përfaqësues nga strehimorja, anëtar;
- 1.10. Bekim Krasniqi Përfaqësues nga OJQ-të në nivelin lokal, anëtar;

2. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, ftohen të jenë pjesë në Mekanizmin Koordinues Lokal:

- 2.1. Bekim Dugolli, Mbrojtësi i Viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, anëtar;

- 2.2. Zenel Tasholli, Përfaqësues nga Gjykata, anëtar;
- 2.3. Përfaqësues nga Prokuroria, anëtar;
- 2.4. Brahim Shatrolli, Përfaqësues nga Policia; anëtar
- 2.5. Zana Bikliqi Berbatovci, Përfaqësuese nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, anëtare;
- 2.6. Ganimete Dragaqina, Përfaqësuese nga Zyrat e Punësimit, anëtare;
- 2.7. Xhyljeta Humolli, Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor, anëtare.

3. Në mungesë të Kryesuesit, rolin e Zëvendëskryesuesit të Mekanizmit Koordinues Lokal e ushtron Nënkryetari i parë i Komunës.

4. Mekanizmi Koordinues Lokal sipas nevojës mund të ftojë në takim edhe përfaqësues të institucioneve relevante.

5. Kryetari i Komunës për mbështetje administrative teknike cakton sekretarinë e Mekanizmit Koordinues Lokal.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit Koordinues Lokal

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit Koordinues lokal në përgjithësi dhe detyrat e kryesuesit dhe anëtarëve të Mekanizmit koordinues në veçanti , takimet , trajnimi dhe procedura e raportimit janë të përcaktuara me dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.01/2025 për Mekanizmin koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje , dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-13721

Lipjan, më 24.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

